



LIGJ

Nr. 8999, date 30.01.2003

PER NJE NDRYSHIM NE LIGJIN NR.8449, DATE 27.1.1999 "KODI DOGANOR I REPUBLIKES SE SHQIPERISE", NDRYSHUAR ME LIGJIN NR.8473, DATE 14.4.1999

Ne mbështetje te neneve 78, 81 pika 2 shkronja "d", 83 pika 1 dhe 155 te Kushtetutës, me propozimin e Këshillit te Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKES SE SHQIPERISE

VENDOSI:

Ne ligjin nr.8449, date 27.1.1999 "Kodi doganor i Republikës se Shqipërisë" , ndryshuar me ligjin nr.8473, date 14.4.1999, behet ky ndryshim:

Neni 1

Pika 4 e nenit 199 te ligjit nr.8449, date 27.1.1999, ndryshohet si me poshtë:

"4. Ministri i Financave mund te autorizoj hapjen e "Duty free shops", (dyqane te çliuara nga taksat) ne aeroporte, qe ndodhen ne zonën doganore te territorit doganor te Republikës se Shqipërisë, për shitjen e produkteve, me përjashtim nga detyrimet e importit. Formalitetet dhe procedurat qe ndiqen ne këto raste përcaktohen me vendim te Këshillit te Ministrave. " .

Neni 2

Dispozite kalimtare

Pas pikës 4 te nenit 199 te ligjit nr. 8449, date 27.1.1999, shtohet pika 5 me këtë përmbajtje:
"5. Autorizimet e regjimit te magazinës doganore te tipit C, te miratuara deri ne hyrjen ne fuqi te këtij ligji, për hapjen e "Duty free shops" (dyqane te çliuara nga taksat), ne zonat doganore tokësore, kufitare, dhe ne portet detare, me përjashtim te atyre te aeroporteve, revokohen pas 30 ditëve nga hyrja ne fuqi e këtij ligji. Pas kësaj date, mallrave gjendje u jepet njeri nga destinacionet doganore, te parashikuara ne dispozitat e këtij kodi, ndërsa te gjitha "Duty free shops", me përjashtim te atyre ne aeroporte, mbyllen.

Neni 3

Ngarkohet Ministria e Financave për zbatimin e këtij ligji.

Neni 4

Ky ligj hyn ne fuqi 15 dite pas botimit ne Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr. 3689, date 10.2.2003 te Presidentit te Republikës se Shqipërisë, Alfred Moisiu..